

## **INTER-CONNECT - Takimi Inicives KoM (Igoumenitsa /Greqi)**

Më datat 13 dhe 14 mars 2018, në Bashkinë e Igumencës, u zhvillua takimi inicives (*Kick off Meeting*) i projektit INTER – CONNECT (Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilindja Hekurudhore në Rajonin Adriatik – Jonian), financuar nga Programi ADRION INTERREG. Në këtë projekt Bashkia e Igumencës është partneri kryesor dhe udhëheqës i projektit, ndërkohë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është partner, dhe Autoriteti Portual Durrës është partner i asociuar.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë së Igumencës, z. Ioannis Lolos, i cili në fjalën e tij përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe partnerët e projektit për suksesin në finalizimin e financimit të tij dhe theksoi se projekti INTER – CONNECT paraqet një mundësi të shkëlqyer në përmirësimin e ndërlidhjes kryesisht për udhëtarët, për të gjitha vendet në rajonin Adriatik – Jonian. Gjatë takimit u theksua se propozimet konkrete për zbutjen e joefikasitetit ekzistues, lidhjes dhe ndërveprimit, si dhe zhvillimit të transportit intermodal në Rajon do të jenë ndër kontributet kryesore për planin e veprimit, që do të zhvillohet gjatë zbatimit të projektit.

Në takim ishin të pranishëm të gjithë partnerët e projektit, të cilët diskutuan rreth aktiviteteve që duhet të zbatohen. Nga drejtuesit e Projektit u paraqiti një pasqyrë e përgjithshme e projektit dhe planit të punës, si dhe u informuan pjesëmarrësit rreth fazave të projektit, aktiviteteve kryesore që duhen zbatuar, si dhe procedurave të raportimit.

Gjatë takimit pati tri seanca diskutimesh teknike, duke u ofruar partnerëve të projektit një analizë të thellë të rezultateve kryesore të pritura të projektit INTER-CONNECT, si më poshtë:

- Agjencia Rajonale e Zhvillimit të Rajonit të Lubjanës u përqendrua në kapitalizimin e njohurive ekzistuese në transportin intermodal të udhëtarëve dhe përdorimin e transportit hekurudhor për këtë qëllim (nga dokumentet e politikave dhe strategjitë si dhe nga praktikat më të mira të mëparshme), si bazë për zhvillimin e analizës së re INTER-CONNECT.
- Instituti Italian i Transportit dhe Logjistikës theksoi rolin themelor që do të kenë 8 rastet studimore, që do të zhvillohen në kuadër të projektit INTER-CONNECT, të cilat do të bëjnë të mundur të kuptohet më të mirë rajoni Adriatik – Jonian, në aspektin e nevojave, sfidave dhe potencialeve për promovimin e intermodalitetit të pasagjerëve.
- Instituti Grek i Transportit (Qendra për Kërkime dhe Teknologji) prezantoi udhërrëfyesin e transportit intermodal të pasagjerëve, që do të përcaktohet në kuadër të projektit. Bazuar në përvojën e fituar gjatë zbatimit INTER-CONNECT, një strategji për rajonin e ADRION-it do të japë informacion për politikën e ardhshme, duke përgjithësuar dhe përkthyer rezultatet e projektit në rekomandime për veprime të ardhshme publike dhe private për promovimin e transportit intermodal dhe atij hekurudhor.
- Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI) - do të ketë rolin e Sekretarisë Ekzekutive dhe do të jetë përgjegjëse kryesisht për aktivitetet e komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit të projektit. Përfaqësuesi i CEI-t dha një pasqyrë të veprimeve të planifikuara që do të zbatoheshin gjatë tërë jetës së projektit dhe theksoi rëndësinë e përfshirjes efektive të të gjithë partnerëve dhe palëve të interesuara në zbatimin e INTER-CONNECT.

Së fundi, pjesëmarrësit diskutuan rreth rrugës për përcaktimin e strategjisë INTER-CONNECT, me qëllim promovimin zhvillimin e transportit intermodal dhe hekurudhor në rajon Adriatik - Jonian.

Takimi i ardhshëm, në kuadër të këtij projekti parashikohet të zhvillohet në Bolonjë, në qershor 2018.